



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.975/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me procesmbajtëse Pranvera Gashi në kontestin tregtar administrativ të paditësit S-Imeri SHPK me seli në Gjakovë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.S. Avokate në Gjakovë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 21,554.79 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me datë 16.06.2023, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Avokate E.S., e në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit S-Imeri SHPK me seli në Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.S. Avokate në Gjakovë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr. 91/2020 i datës 22.07.2020, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 10.08.2020, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj vendimit nr. 91/2020 i datës 22.07.2020. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e paditësit deklaroi: Pas dëgjimit të ekspertëve u vërtetuan pretendimet e paditësit se përlllogaritjet nga organi administrativ në këtë çështje nuk janë kryer në mënyrë profesionale dhe jo të saktë andaj, bëj precizimin e kërkesëpadiës duke u bazuar në ekspertizën financiare dhe sqarimet e ekspertit financiar në këtë seancë dhe atë si në vijim : të aprovohet padia dhe kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet vendimi kontestues nr.91/2020 i datës 22.07.2020

si jo i ligjshëm dhe jo i drejte si dhe të obligohet e paditura ATK që këtu paditësit t ia kthej mjetet e paguara më tepër dhe atë për vitin 2016 në emër të TAP shumën prej 5,010.51 euro dhe në emër të TVSH-së shumën prej 9,018.92 euro, për vitin 2017 në emër të TAP shumën prej 2,687.63 euro dhe në emër të TVSH- së shumën prej 4,837.73 euro , e të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 21,554.79 euro . E njoftoj gjykatën se të gjitha pagesat e konstatuara me raport kontrolli janë paguar dhe si dëshmi gjykatës i janë bashkangjitur pagesat në shkresat e lëndës. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 02.08.2021, ka kundërshtuar pretendimet e paditësit të paraqitura në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale. ATK-ë, si palë e paditur në këtë rast, për qëllime të përgjigjes në padi i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pa bazuar në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së nr. 91/2020 datë 22.07.2020 është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, Andaj i propozon gjykatës që të refuzoj padinë e paditësit duke vërtetuar Vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së nr. 91/2020 datë 22.07.2020 lidhur me subjektin S-Imeri SHPK me seli në Gjakovë. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i të paditurit edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, ndërsa me parashtresën – njoftimin e datës 14.06.2023 e njofton Gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë duke kërkuar nga Gjykata të veproj në pajtim me nenin 38, par. 5 të LKA-së, ndaj gjykata ka proceduar tutje komfor nenit 41, të LKA-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 16.06.2023 ka administruar provat dhe atë: Raporti i ri-kontrollit nr.7/2017 i datës 21.02.2020, Ankesa e ushtruar në ATK e datës 02.03.2020, Vendimi nr.91/2020 i datës 22.07.2020, Polica e sigurimit e datës 28.05.2020, Pasqyrat financiare për vitin fiskal 2019, Përgjigja në padi e datës 02.08.2021, Tabela e stoqeve fillestare e viti 2016, Tabela e përpiluar me datë 24.01.2020 , artikujt e blerë për periudhën 01.01.2016 deri 31.11.2016, Tabela e përpiluar me datë 23.01.2020 , artikujt e blerë për periudhën 01.01.2016 deri 31.11.2016, Tabela me blerje në detale për projektin Ali ShPK 2016, Birra Peja 2016-2017, B.ZH. 2017, Blue Chip 2016, Princ Coffee House 2017, Format AU 004 së bashku me korrespondencat e datës 21.01.2020, Urdhër pagesat së bashku me pagesat bankare të detyrimeve tatimore të datës

11.12.2020, 20.10.2020, 05.03.2020, 28.09.2020, 10.09.2020, 29.06.2021, 06.05.2021, 05.03.2020, Ekspertiza profesional nga lëmia e ndërtimtarisë e datës 05.03.2022, Ekspertiza financiare e datës 14.10.2022, Raporti i kontrollit i datës 04.10.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, ekspertiza financiare dhe ajo e ndërtimtarisë, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi ka pranuar raportin e kontrollit të datës 20.02.2020, nga e paditura, me ç ‘rast nga gjetjet e të njëjtit është konstatuar qarkullim dhe tatim shtesë për TVSH për periudhat 12/2016 dhe 01-12/2017 si dhe për TAP – PD për vitin 2016. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK-ë, e për të cilën ankesë, ATK-ja me datë 22.07.2020, ka sjell vendimin nr. 91/2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtij paditësi e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 10.08.2020 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Në fakt, në vendimin e kontestuar por edhe në raportin e kontrollit nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike sikurse edhe nga faktet e vërtetuar është nxjerr konkluzion jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Gjykata vëren se e paditura në vendimin kontestues nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore të paditësit sa i përket normativit të aplikuar për artikuj të caktuar sikurse në raport të kontrollit, vlerës së hapur të tregut dhe informatave nga palët e treta e të cilat kanë rezultuar për këtu paditësin me qarkullim shtesë. Një arsyetim i këtillë i cili nuk e ka shpjeguar bazën ligjore dhe faktike të vlerësimit të gjendjes lidhur me rritjen e

qarkullimit shtesë nga normativi i aplikuar për artikuj të caktuar sikurse në raport të kontrollit, vlera e hapur e tregut dhe informatave nga palët e treta, nga ana e të paditurës është i pa pranueshëm për gjykatën, dhe si i tillë është i barasvlershëm me mungesën e arsytimit.

Gjykata në këtë kontest tregtar administrativ e duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse ka aprovuar nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së ndërtimtarisë nga eksperti S.B. dhe asaj financiare nga eksperti Vehbi Emini.

Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit të ndërtimtarisë është dhënë mendimi profesional si në ekspertizë, ndërsa nga sqarimeve e ekspertit S.B. dhënë në seancën e datës 16.06.2023, e ku deklaroi se: *mendoj se përfaqësuesit e ATK-së sipas bindjes time profesionale iu kanë dhënë rëndësi vetëm atyre dokumenteve të cilat atyre iu është dashur të arrijnë qëllimin e realizimit të raportit të kontrollit. Kuti qasemi dokumentacionit teknik konkretisht situacionit dhe librave ndërtimor, duhet pas parasysh përveç ofertës dhe kontratës edhe ti qasen normave ndërtimore në bazë të së cilave janë llogaritur sasi dhe përshkrimi teknik të paraqitura në ofertë respektivisht në para masë dhe para llogaritjes së punës së kryesit dhe investitorit. Arsyeja është se nuk kanë pasur mundësi teknike të përshkruajnë secilën pozicion me njësi matëse , me sasi dhe me renditje të punëve që është dashur të kryhen, por punë kryesi me investitorin me situacione të përkohshme në vend shikim kanë konstatuar se si të kryhet dhe çdo pozicion punonjës pas përfundimit final është nënshkruar nga përfaqësuesi profesional i të dy palëve. Këto dokumente në përgjithësi mi ka siguruar punë kryesi. Kështu që mund të konstatoj se përveç punëve operative është hartuar dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm administrativ, gjykata nxjerr konstatimin se e paditura nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e këtij paditësit në procedurë ankimore, nuk e ka trajtuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm kontabël dhe teknik për të konstatuar saktë gjendjen faktike dhe për të mundur të aplikoj saktë edhe të drejtën materiale.*

Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar është dhënë mendimi profesional si në ekspertizë, ndërsa nga sqarimeve e ekspertit Vehbi Imeri dhënë në

seancën e datës 16.06.2023, e ku deklaroi se: *Duke pas parasysh se çështjet të cilat u ngritën në formë të pyetjes, unë jam bazuar në ekspertizën profesionale të ndërtimtarisë dhe duke u bazuar në të njëjtën ka rezultuar se në vitin 2016 dhe 2017 ATK-ja me raportin e ri-kontrollit të datës 20.02.2020, si dhe të vërtetuar me vendimin e departamentit të ankesave, kemi ndryshime sa i përket qarkullimit shtesë dhe bazës nga e cila ka rrjedhur ky qarkullim shtesë, nga e cila ka rezultuar tatimi shtesë në të ardhura të Korporatave si dhe tatimi shtesë për TVSH. Pasi që kërkesa është specifike po jap vlera të cilat janë trajtuar sa i përket qarkullimit shtesë si dhe tatimit shtesë për dy vitet dhe atë si në vijim: -Viti 2016 qarkullimi shtesë i konstatuar me raport kontrolli ka qenë 66,235.42 euro , ndërsa tatimi në të ardhura të korporatave ka qenë 6,623.54 euro. TVSH 11,922.38 euro, ndërsa sipas mendimit tim qarkullimi shtesë rezulton të jetë 16,130.29 euro . Tatimi në të ardhura të korporatave 1,613.03 euro dhe TVSH 2,903.45 euro , diferenca në mes të raportit të kontrollit dhe ekspertizës është qarkullimi shtesë 50,105.13 euro, TAP 5,010.51 euro dhe TVSH 9,018.92 euro. -Viti 2017 qarkullimi shtesë i konstatuar me raport kontrolli ka qenë 31,804.11 euro , ndërsa tatimi në të ardhura të korporatave ka qenë 3,180.41 euro. TVSH 5,724.74 euro, ndërsa sipas mendimit tim qarkullimi shtesë rezulton të jetë 4,927.82 euro . Tatimi në të ardhura të korporatave 462.78 euro dhe TVSH 887.01 euro , diferenca në mes të raportit të kontrollit dhe ekspertizës është qarkullimi shtesë 26,876.29 euro, TAP 2,687.63 euro dhe TVSH 4,837.73 euro, gjykata nxjerr konstatimin se kjo ekspertizë është e bazuar në atë të ndërtimtarisë e e cila ekspertizë ka konstatuar se e paditura nuk ka trajtuar të gjithë dokumentacionin relevant kontabël dhe teknik, si dhe ekspertiza financiare ka konstatuar një gjendje financiare obliguese ndaj këtu paditësit që ndryshon nga e paditura sikurse me raport kontrolli të datës 20.02.2020.*

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, Gjykata duke qenë se bazuar në dispozitën nga neni 44, par 1, i LKA-së, ku është përcaktuar qartë se *Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga Padia, dhe pasi që ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimit të të paditurës, sa i përket konstatimit të gjendjes faktike respektivisht qarkullimit shtesë nga normativi për artikujt e ndryshëm sipas raportit të kontrollit dhe pasi që ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura duke mos i arsyetuar mjaftueshëm me prova*

konkrete, kjo e vërtetuar edhe me ekspertizën e ndërtimtarisë të datës 05.03.2022, ekspertizë kjo në të cilën është e bazuar edhe ajo financiare.

Gjykata nga vendimi kontestues ka gjetur se e paditura nuk ka qenë në gjendje në asnjë moment të arsyetoj se mbi cilën gjendje faktike dhe bazë ligjore ka aplikuar normativin për artikuj të caktuar sipas raportit të kontrollit, ka aplikuar vlerën e hapur të tregut, ka aplikuar informatat nga palët e treta, se për cilat projekte të punuara nga këtu paditësi e paditura ka kalkuluar sasi blerëse, në cilat fatura blerëse është bazuar e paditura kur ka kalkuluar këtë sasi blerëse për paditësin, si ka aplikuar normativin nga palët e treta dhe si të njëjtin e ka ndërlidhë me normativin e këtu paditësit, cilat dokumentacione teknike të këtu paditësit janë trajtuar nga e paditura dhe në të cilat nga këto dokumentacione është bazuar e njëjta kur ka konstatuar qarkullim shtesë, pse nuk janë vlerësuar në procedurë ankimore situacionet të cilat janë të përkohshme për kryerjen e obligimeve financiare që është punuar apo realizuar ndërtimi brenda një muaji, a është trajtuar dokumentacion teknik që mbetet gjithmonë përderisa ekziston objekti siç është libri ndërtimor i cili punohet në dy ekzemplarë dhe i cili përmban me vete sasinë e punëve të kryera sipas pozicioneve me çmime kontraktuese të dakorduara për njësi matëse, për të nxjerr konstatime të sakta të gjendjes faktike dhe për të mundur të aplikoj saktë të drejtën materiale.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së. Duke pasur parasysh konstatimet e lartcekura, gjykata konkludon se në këtë kontest tregtar administrativ ekzistojnë të meta të cilat pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë për arsye se në vendimin kontestues nuk janë dhënë arsye të bazuara lidhur me konstatimin e normativit për artikuj të caktuar sipas raportit të kontrollit, ka aplikuar vlerën e hapur të tregut, ka aplikuar informatat nga palët e treta, për periudhën e kontrollit 2016 dhe 2017.

Gjykata kërkon nga e paditura të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen e saktë sa i përket normativit për artikuj të caktuar sipas raportit të kontrollit, vlerës së hapur të tregut, dhe informatave nga palët e treta, për periudhën e kontrollit, bazuar në situacionet e përkohshme të aplikuara gjatë ndërtimit të objektit, në librin ndërtimor, faturave, ofertave dhe kontratave ndërmjet punë kryerësit dhe investitorit. E paditura në rivendosje lidhur

me këto çështje të marr për bazë edhe të gjeturat nga ekspertiza e ndërtimtarisë e datës 05.03.2022 dhe ajo financiare e datës 14.10.2022, dhe vetëm pas kësaj dhe mbi bazën e këtyre ekspertizave të marr vendim meritor në këtë çështje.

Të metat e cekura më lartë pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t'i mënjanoj këto të meta të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, dhe në vështrim të neneve 43, paragrafi 1, dhe 44, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata Ligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar e shqyrton brenda kufijve të kërkesës nga padia, andaj edhe e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritorë në këtë kontest tregtar administrativ ngase vet eksperti i ndërtimtarisë e në të cilën ekspertizë është e bazuar edhe ajo financiare në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16.06.2023, shprehimisht thekson se *mendoj se përfaqësuesit e ATK-së sipas bindjes time profesionale iu kanë dhënë rëndësi vetëm atyre dokumenteve të cilat atyre iu është dashur të arrijnë qëllimin e realizimit të raportit të kontrollit. Kuti qasemi dokumentacionit teknik konkretisht situacionit dhe librave ndërtimor, duhet pas parasysh përveç ofertës dhe kontratës edhe ti qasen normave ndërtimore në bazë të së cilave janë llogaritur sasi të dhe përshkrimi teknik të paraqitura në ofertë respektivisht në para masë dhe para llogari të projektit, por edhe për faktin se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon vendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në këtë pjesë. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedure të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.*

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2, dhe 46 par 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Departamenti Fiskal, Dhomat e Shkallës së Parë

KF.nr.957/22, datë 16.06.2023

Procesmbajtëse

Pranvera GASHI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.